



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XXXIV-të (tridhjetekatër - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 09 qershor 2025

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, znj.Fikmete Qurkollli, z.Selver Rama, ndërsa mungoi z.Florent Hasani.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Bahri Selimi drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK; Shefqet Ismajli dhe Astrit Rexhepi nga Stacioni i Policisë në Podujevë; Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE; Zita Rasztik përfaqësuese e KFOR-LMT.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj në vazhdim po lexoj rendin e ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 08.05.2025

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali për ndonjë vërejtje gjatë diskutimit nëse jo e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët/e e Komitetit sa ishin prezent, pa vërejtje apo plotësime ndryshime miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 08.05.2025.

2. Informatë e nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, rreth realizimit të projekteve që ndikojnë drejtpërdrejt te Komuniteti jo shumicë në Komunën e Podujevës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë nuk e di se a kanë bërë kërkesa në Komunë, por ne e kemi paraparë këtë dhe i kemi disa kërkesa të cilat do t'i shpalosi tani këtu, e para ka të bëjë me ujin e pijes në rrugën “Ali Ajeti” ku jetojnë komuniteti jo shumicë që është kërkesë e kamotshme ku në bisedë e sipër me Kryetarin e Komunës na ka treguar që këtë projekt e kanë marr për të punuar e që janë edhe mjetet financiare, mirëpo puna ende nuk ka filluar dhe arsyen nuk e di përse, por tash është kohë e verës dhe uji është më i nevojshëm.

Kërkesa e dytë ka të bëjë me rrugën e cila ka nevojë për asfaltim sepse është dëmtuar shumë për arsyeje se janë bërë kanalizimet ujësjellësi e më pastaj është dëmtuar rruga dhe është bërë me shumë gropa dhe nëse lëshohet uji aty rruga vetëm dëmtohet edhe më shumë, kështu që do të ishte mirë që të bëhet asfaltimi i kësaj rruge, ndërsa si kërkesë tjetër është edhe ndriçimi i rrugës së parë “Ali Ajeti” ku aty ka qenë ndriçimi por pasi që janë vendosur shtyllat ajo rrugë ka mbetur pa ndriçim. Po ashtu përveç kësaj, si kërkesë e radhës është edhe fusha e sportit që është në lagjen e cekur dhe ka nevojë të bëhen disa renovime.

Pra këto janë kërkesa momentale që kanë të bëjnë me lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rrugën “Ali Ajeti”.

Në rrugën “Xhafer Meta” ku po ashtu jetojnë komuniteti jo shumicë, për këtë lagje sigurisht do t'ia jap fjalën znj.Shkurte Sejdiu në mënyrë që ti tregon kërkesat e tyre sepse është përfaqësuese e asaj lagjeje.

Përveç kësaj, unë e kam edhe një kërkesë apo porosi nga fshati Orllan ku po ashtu jetojnë komuniteti jo shumicë, ka të bëjë me një rrugë me kubëza e cila ka mbetur në gjysmë dhe arsyen nuk e di, por që kanë kërkuar që brenda mundësive të vazhdoj aty ku ka mbetur rruga, ndërsa për kërkesat tjera do të na informoj tani znj.Shkurte Sejdiu.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, përshëndetje për të gjithë, kërkesat për lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rrugën “Xhafer Meta” kanë të bëjnë me kanalizimin e rrugës ku ky kanalizim pothuajse çdo ditë është i mbyllur dhe kundërmon një erë e rëndë në tërë lagjen.

Po ashtu kur është bërë asfaltimi i rrugës është bërë vetëm gjysmë rrugë por jo e gjitha. Përveç kësaj, kërkesë tjetër e jona në atë lagje është që te rruga “Bedri Ahmeti” shtrati i lumit apo siç quhet reka që kalon në atë lokalitet, pra nëse nuk mund të bëhet ndonjë ndërtim të paktën të bëhet pastrimi i atij shtrati sepse po ka shumë mbeturina dhe insekte të ndryshme.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, përshëndetje për të gjithë, këtu me të drejtë jemi duke folur për kërkesat e komunitetit jo shumicë në Komunën tonë, ne i kemi marr dhe i kemi shqyrtuar pothuajse të gjitha kërkesat e tyre që kanë ardhur nga vetë përfaqësuesit e komunitetit jo shumicë dhe t'ju them të drejtën prioritet i kemi dhënë dy projekte të cilat kemi menduar që janë më të rëndësishme për komunitetin ku njëra është në rrugën “Xhafer Meta” ndërsa tjetër në rrugën “Ali Ajeti”.

Këtu u përmend edhe çështja e ujësjellësit, pra uji i pijes në rrugën “Ali Ajeti” ku jetojnë komuniteti jo shumicë, por sa i përket ujësjellësit siç e dini kemi dërguar kërkesa disa herë në Ministrinë e Ekonomisë në mënyrë që të ndahet buxheti për Komplainë Regjionale të Ujësjellësit “KRU Prishtina”, sepse duhet ta kemi të sqaruar një gjë se projektet e zgjerimit të ujësjellësit nuk i bënë Komuna por i bënë Ndërmarrja publike regjionale “KRU Prishtina”, dhe në bazë të kërkesës që e kemi drejtuar, tani jemi njoftuar nga Ministria që është ndarë buxheti për zgjerimin

apo rregullimin e projektit të ujësjellësit në rrugën “Ali Ajeti” kërkesë e cila është e kamotshme dhe e arsyeshme.

U përmend që nuk është bërë projekti dhe nuk po shihet puna, mirëpo duhet ta dimë se fillimisht është ndarë buxheti dhe kjo është e mira e këtij projekti, mandej do të filloj faza e projektimit dhe në fund do të fillojnë punimet. Ky projekt duhet të përfundoj për shkak se kështu na është thënë edhe nga Ministria dhe tashmë mjetet buxhetore janë bartur te “KRU Prishtina” dhe besojmë që së shpejti do të fillojnë punimet.

Prioriteti i dytë dhe jo më pak i rëndësishëm është edhe pastrimi i kanalit që u përmend në lagjen ku jetojnë edhe komuniteti jo shumicë në rrugën “Xhafer Meta” ku për këtë ne vetë i kemi zhvilluar procedurat sepse është projekt që i takon Komunës, pra i kemi zhvilluar procedurat e hartimit të projektit por fatkeqësisht ka mbetur pezull për shkak të një ankese që është bërë në Organin Shqyrtues të Prokurimit-OSHP për çka jemi duke pritur përgjigje nga këta në mënyrë që të fillojmë punën në këtë projekt, pra në bazë të idesë që ne e kemi dhënë për hartimin e këtij projekti, këtu kemi paraparë që të ndërtojmë komplet kanalin, pra ta betonojmë dhe do të jetë një kanal i betonuar ku komplet kanali që fillon nga rruga magjistrale në afërsi të Qendrës Tregtare “Agnesa” deri te rruga “Skënderbeu” e që i gjithë kanali është planifikuar në bazë të idesë që ne kemi dhënë të bëhet pastrimi dhe betonimi i atij kanali dhe vendosja e urave aty ku është e nevojshme dhe ku kërkohet kalimi i këtij kanali për çka shpresojmë që të jetë një ndër kanalet më të rregulluar, mirëpo duhet ta kemi të qartë që fillimisht të presim hartimin e projektit e më pastaj të zhvillojmë procedurat e prokurimit gjë që do të merr pak kohë, por e mira e gjithë kësaj është se kemi fituar një buxhet nga Ministria e Infrastrukturës në vlerë prej 4,000,000.00 euro për rregullimin e shtretërve të lumenjve ku në kuadër të kësaj është edhe rregullimi i këtij kanali që e kemi si kërkesë nga banorët jo vetëm të komunitetit jo shumicë por nga të gjithë banorët e asaj lagjeje.

Ndërsa sa i përket rrugëve edhe atyre kërkesave infrastrukturore siç është asfaltimi i disa rrugëve dhe disa rrugë me kubëza, unë me sa e di është bërë një rrugë me kubëza dhe do të vazhdoj ajo prap, pra do ta shqyrtojmë si kërkesë, ndërsa asfaltimet e rrugëve këtu e mira e krejt kësaj është se tash jemi në fazën e dëgjimit buxhetor ku i marrim kërkesat e të gjithë banorëve dhe nganjëherë është mirë që të merrni edhe ju pjesë në këto dëgjime buxhetore sepse në dëgjime buxhetore marrim drejtpërdrejt kërkesat pastaj sigurisht që do të trajtohen me prioritet, mirëpo sa pash unë nuk ka pasur kërkesa shumë të mëdha. Te kërkesat për infrastrukturë që u theksuan diçka kemi bërë tashmë sa për informacionin sepse më duket që nuk u përmenden nga parafolësit, në fshatin Dumnice aty jeton një familje e komunitetit jo shumicë e kemi trajtuar një rrugë me zhavorr ku kemi bërë një rrugë të kalueshme sepse ka qenë e pa kalueshme, pra sigurisht që më vonë do të intervenojmë edhe me asfalt apo me kubëza varësisht se si kërkohet apo si është e nevojshme.

Rreth asaj që u theksua për kanalin e rrugës apo kanalizimin në rrugën “Bedri Ahmeti”, kjo çështje sa jam në dijeni unë është një pjesë e dëmtuar në fund të asaj rruge “Bedri Ahmeti” ku e kemi vizituar dhe e kemi parë problemin dhe kjo do të rregullohet së shpejti, pra është çështje ditësh. Po ashtu u përmend që gjatë punimit të rrugës është bërë dëmtimi dhe tash nuk e di saktë se pjesa tjetër a është e gjitha në gjendje të rregullt apo nuk është, mirëpo ajo pjesa e cila është dëmtuar do të rregullohet shumë shpejt.

Pra këto janë të gjitha ato që ne i kemi planifikuar t’i rregullojmë dhe që i dëgjova nga ju si kërkesa që siç e ceka nga infrastruktura janë kërkesa shumë të mëdha, pra janë kërkesa që mund të realizohen lehtë, mirëpo prapë duhet të theksojmë që me prioritet i kemi marr këto dy kërkesa që ishin ujësjellësi në rrugën “Ali Ajeti” dhe hapja e kanalit në rrugën “Xhafer Meta”.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e falënderoj drejtorin parafolës për informacionet dhe sqarimet e dhëna, pra urdhëroni nëse ndokush tjetër ka pyetje apo çështje tjera, nëse jo atëherë unë edhe njëherë e falënderoj shumë drejtorin parafolës për dy projektet e cekura që ju ka dhënë rëndësi dhe prioritet të cilat duhet të realizohen sipas mundësive buxhetore, por pasi që Ministria përkatëse veç paska bartur mjetet financiare tek “KRU Prishtina” po besoj që edhe puna do të fillon shumë shpejt.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

3. Informatë e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete në koordinim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, për vizitat në Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta – SHFMU “Shaban Shala” dhe “Naim Frashëri” në qytet ku mësimin e vijnë edhe nxënësit e Komuniteteve jo shumicë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne i kemi vizituar këto dy shkolla së bashku me z.Liman Zeqirin. Në shkollën “Shaban Shala” jemi takuar me drejtorin e shkollës i cili na ka pritur shumë mirë dhe na ka informuar për vijimin e nxënësve të komunitetit jo shumicë në këtë shkollë ku janë 7 deri 12 nxënës që e vijnë mësimin në këtë shkollë, pra është një numër më i vogël i komunitetit jo shumicë por çka është me rëndësi këta 12 nxënës janë nxënës të mirë mirëpo edhe nuk ka braktisje në këtë shkollë, informata këto që na janë dhënë nga drejtori i shkollës. Ndërsa në shkollën “Naim Frashëri” janë 70 nxënës të komunitetit jo shumicë që e vijnë mësimin, mirëpo ka mungesa të shumta të nxënësve të komunitetit jo shumicë ku drejtori dhe profesorët janë ankuar lidhur me këto mungesa. Përveç kësaj është formuar komisioni për mos braktisje, edhe pse kemi disa raste që kanë tentuar të braktisin shkollën por kemi arritur t’i kthejmë e që 1 nxënëse e klasës IX ka filluar të braktis por me ndihmën e drejtorit dhe zëvendës drejtoreshës po ashtu edhe interesimi dhe angazhimi im për këtë rast kemi arritur që atë nxënëse të kthejmë në bankat shkollore me qëllim që të përfundon klasën e IX, ndërsa për vijimin e shkollës së mesme pastaj është çështje individuale e saj, por në bazë të përvojës që kemi deri më tani të gjithë nxënësit e komunitetit jo shumicë e kanë përfunduar klasën e IX janë regjistruar në shkollë të mesme dhe nuk kam informatë për ndonjë që nuk është regjistruar edhe pse nga drejtorët e shkollave kemi pasur tolerancë ku nxënësit tanë janë pranuar në shkolla edhe nëse nuk i kanë pasur notat apo suksesin e nevojshëm.

Për ata që kanë munguar më shumë, është bërë e mundshme që të mbahet një provim me qëllim të kalimit të vitit dhe mos humbjes së vitin shkollor.

Pra këto ishin informtat që kam, por për më shumë i’a jap fjalën z.Liman Zeqirit sepse edhe ai ka qenë së bashku me mua në vizitat që i kemi bërë në shkolla.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, falënderoj drejtorin parafolës të DSHPMSH që ka gjetur kohë dhe ka ardhur për të dhënë këto informacione të cilat mund të themi se janë nga dora e parë që për këtë pikë të rendit të ditës e kemi pasur edhe një takim më herët, por ajo që është në interes të gjithë qytetarëve me theks të veçantë për komunitetin jo shumicë dhe avancimin e tyre për të gjitha të drejtat që i takojnë qoftë në arsim, shëndetësi, infrastrukturë e të tjera si qytetarë të nderuar të këtij vendi që jetojmë.

E falënderoj qeverinë aktuale e në veçanti Kryetarin e Komunës që ka qenë gjithmonë i angazhuar për respektimin e të gjithë qytetarëve pa dallim. Ajo që më impresionoj nga drejtori parafolës janë dy projektet më të mëdha por edhe ato më të vogla që do të realizohen. Është mirë që ne dhe angazhimi i juaj si dhe përfaqësuesit e lagjeve të juaja si komunitet jo shumicë por

edhe nga drejtori me stafin e tij që janë në teren i verifikojnë faktikisht pastaj në anën praktike se ku ka nevojë për të intervenuar e që është interesi jon i përbashkët për të gjithë qytetarët.

Po ashtu ajo që më zgjoj kureshtje ku ka qenë te unë prezent me 14.05.2025 personi me emrin Veli Halili për ndërtimin e shtëpisë që i është bërë në fshatin Dumnicë, dhe me aq shpejtësi t'i rregullohet rruga rreth 200 metra është një punë shumë e mirë, pra është për tu përshëndetur një ndihmë e tillë dhe është në interes tonin që t'i shërbejmë të gjithë qytetarëve. Përveç kësaj ky person ka kërkuar edhe për të kyçur në një kanalizim ku përafërsisht i bije që është 400 metra, dhe nuk i di procedurat qysh janë por duhet të shikojmë se çka mund të bëjmë për këtë, pra dua të di nga drejtori i DSHPMSh se si janë mundësit për kyçje në kanalizim.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, e kam të qartë rastin sepse siç u tha më herët ne kemi intervenuar në infrastrukturë, ndërsa te kyçja e kanalizimit tash për tash nuk kemi mundësi por do ta projektojmë për vitin e ardhshëm sepse nuk kemi kontratë për rregullimin apo ndërtimin e kanalizimit sepse ju e dini që komplet buxheti për kanalizim ka shkuar në kolektorin e ujërave të zeza, kolektor i madh që tashmë u bë viti i dytë që punohet dhe duke i kushtuar rëndësi shumë këtij projekti na kanë mbetur disa projekte lidhur me kanalizimet e shkurta që nuk po kemi mundësi t'i realizojmë, mirëpo vitin e ardhshëm shpresojmë që do t'i përfundojmë.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK, vazhdoi, faleminderit drejtor për përgjigje të vërtetë sepse njeriu është mirë të përgjigjet për atë që e realizon dhe jo vetëm të ketë fjalë e premtime.

Sa i përket arsimit siç e theksoj edhe z.Xhafer Ademi që kemi qenë së bashku në vizitë shkollave në fjalë, drejtorët na kanë informuar lidhur me këtë çështje dhe faktikisht procesi vazhdon shumë mirë ku nxënësit e komunitetit jo shumicë janë të edukuar dhe vijnë në mësimin në shkollat fillore dhe nuk kanë ndonjë problem, në ato raste kur është dashtë që të intervenohet për mos braktisje për çka duhet të falënderohen drejtorët e shkollave po edhe ekipi në nivel Komune që është për parandalimin e braktisjes së nxënësve e po ashtu drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, komunitetin jo shumicë dhe të gjithë që i kanë jap kontribut këtij procesi dhe shpresojë shumë që të vazhdoj ky proces ende kështu ngase sa i përket braktisjes unë mburrem me atë që nuk ka braktisje, por edhe nëse ka pasur ndonjë rast ka qenë periudhë kohore e shkurtër ku me intervenimin e Këshillit të arsimtarëve por edhe Këshillit të prindërve që janë në kuadër të shkollave si dhe faktorëve tjerë ata nxënës/se janë kthyer në procesin mësimor.

Më së shumti që na ka brengosur dhe që ka probleme është klasa e VIII dhe IX që mund të jenë shkaqe të ndryshme qoftë ekonomike, familjare apo personale, ku këto probleme i kemi më shumë te gjinia femërore, por me intervenimet e të gjithëve me kohë qoftë të drejtorëve të shkollave, komisioneve dhe të tjerëve, kemi arritur që ky proces të shkojë mirë dhe të gjithë nxënësit janë kthyer në procesin mësimor për çka dëshiroj që edhe vitet tjera të jenë vite të mira dhe të suksesshme dhe mos ketë braktisje nga shkollat fillore të mesme të ulëta.

Ne si Komunë duhet të krenohemi sepse e vërteta është që ne kemi intervenuar që nxënësit që e përfundojnë shkollën fillore të mesme të ulët, pra klasën e IX, në mënyrë që të regjistrohen në shkollat e mesme për çka e falënderoj edhe drejtorin e Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës që kemi intervenuar edhe në vitin e kaluar në shkollën e mjekësisë, në mënyrë që ata tre nxënës të regjistrohen në shkollën e mjekësisë, pra me ndihëm edhe të Ministrisë dhe Drejtorisë së Arsimit. Edhe këtë vit do të përpiqemi me të gjitha kompetencat tona që kemi si kompetenca ekzekutive do t'i quaja prej Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit që asnjë nxënës i komuniteti jo shumicë të mos jetë jashtë bankave shkollore, por do të mundohemi me të gjitha mundësit së bashku me komunitetin jo shumicë që këta nxënës ta vazhdojnë mësimin në shkollat e mesme sepse pasuria më e madhe e jona është kur krejt komuniteti jo vetëm shumicë sepse integrimi i tyre është pasuri e shtetit tonë në arenën ndërkombëtare sepse tregon që ne jemi

shtet solid, i respektuar për të gjithë, ku respektohen të drejtat e njeriut sepse të drejtat e njeriut janë thelbi i qytetërimit dhe për këtë punojmë dhe do të vazhdojmë të punojmë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin e nderuar z.Liman Zeqiri për informatat që na keni sjellë këtu, nëse nuk ka të tjerë të interesuar për të marr fjalën, atëherë e përfundojmë edhe këtë pikë të rendit të ditës dhe vazhdojmë me pikën e radhës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

4. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nga z.Liman Zeqiri kam pranuar një projekt të Radio Vizionit lidhur me informimin e komuniteteve jo shumicë, ky program ka qenë edhe më herët dhe ka zgjatur bukur shumë dhe është në interes tonin si komunitet sepse kemi marr informata lidhur me Komunën e Podujevës dhe kemi mbajtur trajnime së bashku me gazetarë ku pikërisht sot ka qytetarë nga komuniteti jo shumicë që kanë punuar në këtë drejtim, pra ky projekt është dërguar te z.Liman Zeqiri i cili e ka sjell te unë ku tash e kemi këtu edhe fizikisht.

Ky projekt ka për qëllim fuqizimin e komuniteteve ashkali rom egjiptian në Komunën e Podujevës që bëhet përmes integritit të mediave që përfshin edukimin medial, përdorimin e rrjeteve sociale nëpërmjet emisioneve javore nga 1 orë. Pra ky projekt synon t'i jap hapësirë komunitetit jo shumicë dhe të luftoj dezinformimin si dhe të përfshihet në të gjitha aktivitetet në jetën shoqërore. Ky projekt ka ardhur tek ne, por nuk e di pse ka ardhur këtu në këtë formë sepse ky projekt është dashtë të dërgohet në Drejtorin e Buxhetit dhe Financave sa kam informacione unë, në mënyrë që kuptojmë se a ka buxhet për mbështetje të këtij projekti, nëse kjo Drejtori mund ta mbështet këtë projekt atëherë do të ishte mirë për neve si komunitet jo shumicë.

Sa i përket vlerës së këtij projekti për gjashtë muaj është 6,200 €, kështu që ne këtë projekt po e dërgojmë në Drejtorin e Buxhetit dhe Financave.

Përveç kësaj, dua t'ju informoj lidhur me Planin e Veprimit ku kemi qenë në një trajnim unë me Shoqatën time dhe me Shoqatën Edu, pra kemi qenë 12 organizata dhe ndër to ne jemi zgjedhur Organizata e parë që do ta fitojmë një projekt ku nxënësit e komunitetit rom ashkali dhe egjiptian në bashkëpunim me nxënësit e komunitetit shumicë do të mbajmë një kamp ku do të mësohen gjuhët e huaja për një kohë sa do të zgjat projekti, në rundin e parë e kemi kaluar dhe a do të fitojmë tutje nuk e di sepse duhet të shkojmë më tutje në rundin e dytë, prandaj vetëm deshta t'ju informoj se është bërë një projekt i mirë sidomos për nxënësit e komunitetit jo shumicë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, ne si Zyrë Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK kemi kërkesa të shumta dhe me komunitetin për komunitete është një fat shumë i mirë që takohemi çdo muaj, pastaj ka kërkesa të shumta edhe nga komuniteti shumicë të cilat nuk realizohen ndoshta me muaj të tërë, por është një fat i mirë që në kuadër të kësaj që ne ti shqyrtojmë se si janë mundësit për përmbushjen e këtyre kërkesave dhe të njëjtat t'i prezantojmë. Unë e kam një kërkesë nga z.Bashkim Behluli i cili jeton në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rrugën "Xhafer Meta" ku i njëjti është i sëmure dhe e njohin një pjesë e madhe e qytetarëve i cili po ashtu jeton në gjendje të rëndë ekonomike së bashku me 15 anëtarë të tjerë të familjes duke e përfshirë edhe hallën e tij e cila është në moshën 82 vjeçare të cilën e mban, pra këtu me vete e kam të përshkruar gjendjen në të cilën gjendet ai person, fëmijët e ti vijnë në mësimin në shkollën "Dr. Ibrahim Rugova", dhe ai person ka bërë një kërkesë për ndërtimin e kulmit të shtëpisë, se sa kushton mund ta dinë inxhinierët e Komunës të cilët mund të shkojnë

dhe ta konstatojnë atë, si dhe po ashtu përveç kulmit kërkesa është që t'i rregullohet edhe një banjo/tualet, kërkesë kjo të cilën e ka paraqitur i përmenduri dhe i cili më ka lutur që të paraqes para juve këtu në Komitet për Komunitete në mënyrë që t'i ofrohet ndihmë lidhur me këto dy çështje apo probleme që ka.

Sa i përket projektit të Radio Vizionit që u potencua nga Kryesuesi i Komitetit, mund të them që mediat janë dritare që japin informacione dhe informacioni është arma më e mirë e mundshme në kuptimin pozitiv sepse reflekton drejtpërdrejtë tek qytetarët. E dimë që Radio Vizioni ka pas të punësuar aty persona nga komuniteti jo shumicë. Projekti që na është dërguar neve është dërguar në emër të Komitetit për Komunitete për ta shqyrtuar këtë si kërkesë

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, në këtë projekt të Radio Vizionit parashihen të punësohen dy persona nga radhët e komunitetit jo shumicë.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konstatojmë të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës, respektivisht këtë mbledhje.

Kryesuesi i Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0031164/25
Podujevë, 09 qershor 2025**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**